

Date 10.08.2026

Procesverbal - Tipi i kontratës - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Shërbim mbi hartimin e dy raporteve sipas Urdhrit nr.94, datë 27.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Mbi Raportimin Financiar të Shoqërive të Ujësjetësve në Republikën e Shqipërisë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime të konsulencës për menaxhimin financiar 79412000-5

Vlera e fondit limit: 4.950.000 (katër milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar me VKM-në nr.714, datë 24.11.2021 autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht në vlerën vlerën 99.000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë). (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 19, pika 2, të VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, të ndryshuar.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006)“Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026).**

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

e ndryshuar dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2026 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 si dhe vendimeve respektive të Këshillave Bashkiakë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar ne orgamet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara,

ose

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Audituesi ligjor duhet të paraqesë licencë të vlefshme dhe të jetë i regjistruar në regjistrin publik si Auditues Ligjor për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë, IEKA (Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar).

Argumentimi teknik:

Ky kriter vendoset për të garantuar që operatori ekonomik/personi përgjegjës për realizimin e shërbimit ushtron ligjërisht profesionin e audituesit ligjor dhe plotëson kërkesat profesionale të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi për auditimin ligjor dhe organizimin e profesionit të audituesit ligjor.

Duke qenë se objekti i kontratës lidhet drejtpërdrejt me kryerjen e një shërbimi profesional të auditimit, është e domosdoshme që ky shërbim të realizohet nga subjekte dhe profesionistë të autorizuar dhe të regjistruar për ushtrimin e kësaj veprimtarie. Regjistrimi në regjistrin publik përkatës shërben si provë e statusit profesional dhe e së drejtës për ushtrimin e profesionit.

Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e objektit të kontratës dhe synon të garantojë ligjshmërinë, përgjegjshmërinë profesionale dhe vlefshmërinë e shërbimit dhe të opinionit të auditimit që do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktor.

2.3.3. Të ketë mbi 5 vite eksperiencë në fushën e auditimit ligjor të pasqyrave financiare që mbajnë kontabilitetin sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-ve), kriter që provohet nga regjistri publik i audituesve ligjorë, IEKA, si dhe shoqëria e auditimit duhet të ketë te pakten 3 ekspierienca të ngjashme në 5 vjetet e fundit.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

Argumentimi teknik:

Kërkesa për eksperiencë profesionale mbi 5 vjet është përcaktuar në funksion të natyrës, rëndësisë dhe kompleksitetit të shërbimit që kërkohet të realizohet. Auditimi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas SNRF-ve kërkon njohuri të konsoliduara profesionale, aftësi për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve të raportimit financiar, analizimin e trajtimeve kontabël dhe dhënien e një opinioni profesional të mbështetur në evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi.

Eksperienca e kërkuar krijon siguri të arsyeshme për Autoritetin Kontraktor se audituesi ka ushtruar profesionin për një periudhë të mjaftueshme dhe ka fituar përvojën praktike të nevojshme për trajtimin e çështjeve komplekse që mund të evidentohen gjatë auditimit.

Periudha e kërkuar është përcaktuar për të garantuar një nivel të përshtatshëm eksperience profesionale dhe lidhet me nevojën për realizimin me cilësi të objektit të kontratës.

2.3.4. Audituesi ligjor pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të ketë në staf minimalisht 2 (dy) “Auditues Ligjor”, nga të cilët minimalisht 2 (dy) Auditues Ligjor aktivë me eksperiencë të paktën 5 (pesë) vite duke ushtruar profesionin, kriter që provohet me vërtetim nga Administrata Tatimore sipas formularëve E-SIG 025.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.5. Të paktën 1 (një) prej anëtarëve të ekipit të auditimit që do të angazhohet, duhet të ketë njërën nga titujt: ACCA, CPA, FCCA dhe/ose çdo titull tjetër ekuivalent të tyre, dhe të jetë i deklaruar në listëpagesën e shoqërisë në momentin e lidhjes dhe zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Argumentimi teknik:

Kërkesa që të paktën një anëtar i ekipit të disponojë një kualifikim profesional të avancuar në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, si ACCA, CPA, FCCA ose ekuivalent, është përcaktuar për të garantuar një nivel të lartë të njohurive profesionale në raportimin financiar, auditimin, analizën e pasqyrave financiare dhe standardet profesionale të zbatueshme.

Duke qenë se shërbimi përfshin shqyrtimin dhe auditimin e pasqyrave financiare, përfshirja në ekip e një profesionisti me kualifikim të tillë përbën një kapacitet teknik shtesë për interpretimin dhe zbatimin korrekt të standardeve të raportimit financiar dhe të auditimit.

Pranimi edhe i titujve/kualifikimeve ekuivalente synon të ruajë konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, duke mos e kufizuar kriterin vetëm në një organizëm apo certifikim të caktuar.

2.3.6. Audituesi Ligjor duhet të ketë në dispozicion të paktën **5 (pesë) punonjës**, të angazhuar në mënyrë aktive pranë tij, me **kualifikime profesionale dhe eksperiencë të përshtatshme për realizimin e objektit të kontratës.**

- Personeli i angazhuar duhet të zotërojë, në tërësi, njohuri dhe eksperiencë profesionale në **auditimin dhe kontrollin e llogarive të entiteteve të krahasueshme për nga lloji, përmasat dhe kompleksiteti, vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë së auditimit, si dhe njohuri, trajnime dhe/ose kualifikime në fushën tatimore dhe në zbatimin e legjislacionit fiskal në fuqi**

- Biografite (CV-të) duhet të jepen për drejtorët e firmës audituese, që do të mbajnë përgjegjësi për opinionet dhe raportet e dhëna, bashkë me CV-të e menaxherëve mbikëqyrës dhe të personelit kyç, që do të angazhohet në kryerjen e shërbimit të auditimit. CV-të duhet të përmbajnë detaje të aftësive kualifikuese, certifikata.
- Dokumentacioni provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, janë: Licenca nga IEKA, certifikata të paktën të njërit nga titujt e sipërpërmendur, vërtetim nga Administrata Tatimore sipas formularëve E-SIG 025 (lidhur me eksperiencën në ushtrimin e profesionit), certifikata trajnimesh profesionale si dhe në fushën tatimore dhe zbatimin e legjislacionit fiskal, CV me detaje të aftësive kualifikuese dhe certifikatave.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Argumentimi teknik:

Kërkesa që Audituesi Ligjor të ketë në dispozicion të **paktën 5 (pesë) punonjës të angazhuar në mënyrë aktive**, me kualifikime profesionale dhe eksperiencë të përshtatshme, është përcaktuar në funksion të **natyrës, volumit dhe kompleksitetit të shërbimit të auditimit**, si dhe nevojës për realizimin e tij me cilësi dhe brenda afateve të përcaktuara.

Procesi i auditimit përfshin një sërë veprimtarish që kërkojnë angazhimin e burimeve njerëzore të mjaftueshme dhe me kompetenca të ndryshme profesionale, ndër të cilat: planifikimin e auditimit, identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, shqyrtimin dhe kontrollin e llogarive dhe të dokumentacionit financiar, testimin e transaksioneve dhe kontrolleve të brendshme, vlerësimin e trajtimeve kontabël dhe fiskale, kontrollin e cilësisë së punës së kryer, si dhe përgatitjen e raportit dhe opinionit përfundimtar të auditimit.

Përcaktimi i një ekipi prej **minimalisht 5 (pesë) punonjësish** synon të sigurojë një shpërndarje të përshtatshme të detyrave dhe përgjegjësi, mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës së kryer, vijimësinë e shërbimit, si dhe përmbushjen në kohë të të gjitha procedurave të auditimit, pa krijuar varësi nga një numër i kufizuar personash.

Gjithashtu, kërkesa që personeli, **në tërësi si ekip**, të zotërojë eksperiencë në auditimin dhe kontrollin e llogarive të entiteteve të krahasueshme për nga lloji, përmasat dhe kompleksiteti, është e nevojshme për të garantuar që ekipi të ketë eksperiencën praktike për identifikimin dhe trajtimin e çështjeve që mund të lindin gjatë realizimit të kontratës.

Njohuritë, trajnimet dhe/ose kualifikimet në **fushën tatimore dhe zbatimin e legjislacionit fiskal në fuqi** konsiderohen të nevojshme për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë ndërmjet raportimit financiar, trajtimeve kontabël dhe detyrimeve fiskale, me qëllim identifikimin dhe

vlerësimin e saktë të risqeve që mund të kenë ndikim në pasqyrat financiare dhe në opinionin e auditimit.

Për sa më sipër, kërkesa për disponimin e minimalisht 5 (pesë) punonjësve dhe kompetencat profesionale të kërkuara për ekipin është vendosur për të garantuar **kapacitetin e nevojshëm teknik dhe profesional, ndarjen e përshtatshme të funksioneve, kontrollin e cilësisë dhe realizimin korrekt, të plotë dhe në kohë të shërbimit objekt prokurimi.**

Argumentimi ligjor dhe teknik:

Paraqitja e CV-ve të personelit kyç është e nevojshme për të mundësuar verifikimin konkret të kapaciteteve profesionale të ekipit që operatori ekonomik propozon të angazhojë në realizimin e kontratës.

Nëpërmjet CV-ve Autoriteti Kontraktor mund të verifikojë formimin profesional, eksperiencën, kualifikimet, certifikimet dhe rolin e secilit ekspert në ekip, duke vlerësuar nëse burimet njerëzore të propozuara janë të përshtatshme për detyrat që do të kryejnë.

Kjo kërkesë është e lidhur me kriteret e tjera të kapacitetit teknik dhe profesional dhe shërben si dokumentacion mbështetës për verifikimin e tyre, duke garantuar që personeli i deklaruar disponon realisht profilin profesional të kërkuar.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 41, pika 4/a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.*

Argumentim Teknik

Dokumentacioni i kërkuar në këtë pikë ka karakter provues dhe është përcaktuar për t'i mundësuar Autoritetit Kontraktor verifikimin objektiv të përmbushjes së kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional të personelit të propozuar.

Licencat dhe certifikatat provojnë kualifikimin dhe të drejtën profesionale; dokumentacioni tatimor/listëpagesat provojnë marrëdhënien dhe disponueshmërinë e personelit sipas kërkesave të përcaktuara; certifikatat e trajnimit provojnë përditësimin dhe specializimin profesional, ndërsa CV-të mundësojnë evidentimin e eksperiencës dhe të profilin profesional të secilit anëtar të ekipit.

Kërkimi i këtyre dokumenteve synon që vlerësimi i kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të mbështetet në dokumentacion të verifikueshëm dhe jo vetëm në deklarime të tyre, duke krijuar siguri për Autoritetin Kontraktor se operatori fitues disponon kapacitetet njerëzore dhe profesionale të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Njesia e Prokurimit: